

V E N D I M
Nr. 243, datë 28.5.1999

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 201, DATË
26.3.1998 "PËR KRITERET E PËRDORIMIT TË TË ARDHURAVE NGA SHITJA DHE
QIRAJA E TRUALLIT"**

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës, të neneve 5 e 21, të ligjit nr. 7513, datë 10.8.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit", me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Koordinimit Qeveritar, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.201, datë 26.3.1998 "Për kriteret e përdorimit të të ardhurave nga shitja dhe qiraja e truallit", në pikën 1 të shtohen dy paragrafë, me këtë përmbajtje:

"5 për qind e vlerës totale të të ardhurave në lekë, të arkëtuar nga shitja e trojeve të objekteve të privatizuara nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit, kalon në favor të kësaj agjencie.

Pjesa tjetër, që mbetet nga vlera totale e të ardhurave në lekë, të arkëtuar nga shitja dhe dhënia me qira e truallit, të ndahet".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko